

REPUBLICA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E INDUSTRIË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË
MINISTARSTVO INDUSTRIJE, PREDUZETNIŠTVA I TRGOVINE
MINISTRY OF INDUSTRY, ENTREPRENEURSHIP AND TRADE

Nr./Br./No 439/19 Nr. i faq./Br. str./No. pg _____
Data/Datum/Data 29.01.2024 REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
PRISHTINË



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:054656

Datë: 17.01.2024

Numri i dokumentit: 05203263

Ka. nr. 4/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Azra Cakolli kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Skender Çoçaj anëtarë, në çështjen kundërvajtëse ndaj të pandehurës Subjektit Ekonomik – si person juridik “Labi Oil”, SHPK, me NRB: 810800153, me Drejtor Bislim Muqa, me seli në fshatin Preoc – Komuna e Graqanicës, për kundërvajtje nga neni 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me Produkte të Naftës dhe Karburante të Ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe për kundërvajtje nga neni 26 të sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/L-034 për Mbrojtjen e Konsumatorëve, duke vendosur sipas ankesës të paraqitur nga i pandehuri Subjekti Ekonomik – si Person juridik “Labi Oil”, SHPK, përmes Gafurr Elshanit, avokat nga Prishtina, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Graqanicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K. nr. 117/2023, të datës 12.10.2023, në bazë të nenit 55 par. 3 dhe neni 78, konform të nenit 143 par. 1 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 16.01.2024, mori këtë:

AKTGJYKIM

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga e pandehura “Labi Oil”, SHPK përmes Gafurr Elshanit, avokat nga Prishtina, ndërsa **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Graqanicë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, K.nr. 117/2023, i datës 12.10.2023, si i drejtë dhe i bazuar në Ligj.

Nga një kopje të këtij aktgjykimi duhet dorëzuar palëve.

Arsyetim

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Graqanicë – Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të ushtruar nga ana e MINT-së - Inspektorati i Tregut me Nr. 19/23, të datës 27.01.2023, me numër të protokollit Nr. 899-19, me aktgjykim K. nr. 117/2023, të datës 12.10.2023, të pandehurën subjektin ekonomik si person juridik “Labi Oil”, SHPK, me NRB: 810800153, me Drejtor Bislim Muqa, me seli në fshatin Preoc – Komuna e Graqanicës, e ka shpall përgjegjës sepse:

- Inspektorët e Inspektoratit të Tregut – MINT-së, Sektori i Mbikëqyrjes së Tregut për Naftë dhe Derivate të Naftës, në bashkëpunim me Inspektorët e Administratës Tatimor të Kosovës (ATK-së) me datë 14.02.2023 kanë inspektuar Operatorin Ekonomik “Lab Oil” SHPK, me adresë në fshatin Preoc – Komuna e Graçanicës, lidhur me verifikimin e marzhës tregtare maksimale të lejuar për shitje me pakicë dhe shumicë për secilin produkt të naftës të përcaktuar me Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të Ripërtrishme dhe masat tjera mbrojtëse, bazuar në Procesverbalin Nr. 00053/22 të datës 14.02.2023 dhe në Raportin e Administratës Tatimore të Kosovës, është konstatuar që operatori ekonomik “Lab Oil” SHPK, e ka tejkaluar marzhën tregtare maksimale të lejuar për shitje me pakicë dhe shumicë për produktin të dizellit dhe benzinës dhe nuk e ka respektuar Vendimin e Qeverisë për rregullimin e çmimeve të caktuara, -

-me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 15 të ligjit Nr. 08/L-018 për Tregtinë me produkte të naftës dhe karburanteve të Ripërtrishme, e sanksionuar me nenin 19 par.13 të po të njëjtit ligj, dhe me nenin 26 sanksionuar me nenin 137 të Ligjit Nr. 06/034 për Mbrojtjen e Konsumatorit, e në mbështetje të nenit 35 të Ligjit për Kundërvajtje, i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumë prej **4.000 (katërmijë) €, i cili duhet** paguar në afat prej **30 ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse dënimin e shqiptuar nuk e pague në afatin e paraparë, do të zbatohet ekzekutimi në mënyrë të dhunshme konform nenit 163.4 të LK-së.

Po ashtu i pandehurit obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajnë shumën paushallë prej nga **5(pesë)€, në të njëjtin afat** sikurse dënimin.

Kundër këtij aktgjykimi ka paraqitur ankesë i pandehuri Subjekti Ekonomik – Person juridik “Labi Oil”, SHPK, përmes Gafurr Elshanit, avokat nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të Ligjit materia si dhe për shkak të vendimit mbi dënim, në të cilën veç të tjerash thekson: ka shkelje nga neni 139 par. 1 pika 1.3 të LK-së, kur është ftuar inspektori i cili është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, në bazë të nenit 10 të LK-së, është dashtë të ftohet i pandehuri dhe mbrojtësi pasi që nuk i është dhënë mundësia që i pandehuri të sfidon atë dëshmi, andaj është bërë shkelje e parimit të barazisë së armëve. Vendimi i Qeverisë është në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/L-018 për Tregtinë me produkte të naftës dhe karburanteve të Ripërtrishme, sepse me ligj përcaktohet çartë kur mundet të përcaktohen Çmimet nga Qeveria, sepse nuk ka asnjë analizë e tregut e cila dëshmon se ka çrregullime të tregut apo lëvizje të mëdha të çmimeve të naftës. Po ashtu Raporti i ATK-së, është kundërthënës me pjesët e vet raportit në fjalë sepse ato çmime kanë qenë për shitje me pakicë si që ceket -12 centë dhe se kjo vlerë nuk përmendet në UA e as në Vendim për shitësit me shumicë. Gjykata kushtetuese me Aktgjykim KO173/22, ka shpall të pranueshme Kërkesën e deputetëve. Po ashtu konsiderojnë se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurës është i lartë.

I propozon Gjykatës se Apelit - Divizioni i Kundërvajtës, që ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e goditur ta Ndryshoj duke konstatuar se në rastin konkret se nuk ka kundërvajtje ose ta Anuloj dhe lëndën ta kthej në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatë së Apelit vlerësoj thëniet në ankesën e paraqitur, aktgjykimin e goditur, si dhe shkesat tjera të lëndës dhe konstatoj se ankesa e ushtruar është e pa bazuar dhe refuzohet aktgjykimi i goditur vërtetohet si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e shkallës së parë, me rastin e zhvillimit të procedurës për veprën kundërvajtëse, në bazë të deklaratës së Përfaqësuesit Bislim Muqa, të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësore pranë gjykatës së shkallës së parë, në Procesverbal të datës 20.09.2023, në ç rast Përfaqësuesi i së pandehurës ka deklaruar se në tërësi e kundërshtojnë Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, Vendimi i

Qeverisë nuk mund të zbatohet në praktikë, ndërsa mbrojtësi i tij Gafurr Elshani, avokati nga Prishtina e ka bashkangjitur mbrojtjen me shkrim të cilën e ka dorëzuar dhe është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, në të cilën ka theksuar se Qeveria nuk e ka njoftuar "Oil Lab" se ka nxjerr Vendim për përcaktimin e çmimeve të naftës, duke kërkuar nga gjykata që ta hedh poshtë Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, në bazë të Procesverbalit të datës 12.10.2023, mbi dëgjimin e Inspektorit të Tregut të MINT-së, Taulant Krasniqi, i cili ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë kërkesës pasi që në rastin konkret në bazë të Raportit të përpiluar të Inspektorëve të ATK-së, është vërtetuar se subjekti ekonomik e ka tejkaluar marzhën e përcaktuar sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës, Procesverbalit Nr. 00053/22 i datës 14.02.2023 mbi inspektimin e bërë, Raporti i bërë nga ATK-a, të gjeturat gjatë verifikimit të çmimit të shitjes (marzha e fitimit) duke i krahasuar çmimet e blerjes me çmimet e shitjes me pakicë të aplikuara gjatë periudhës prej datës 10.02.2023 deri në 14.02.2023, Vendimit Nr. 01/04 të datës 08.02.2023, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe nga shkresat tjera të lëndës, pa dyshim se gjykata e shkallës së parë, e ka vërtetuar gjendjen faktike se i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 15 të Ligjit Nr. 08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtrishme, sanksionuar me nenin 19 par. 13 pika 13.1 si dhe kundërvajtje nga neni 26 të Ligjit Nr. 06/L-034, sanksionuar me nenin 137 të Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorëve, për të cilën mban përgjegjësi kundërvajtëse, andaj në këtë drejtim nuk ka bazë për ndryshimin apo anulimin e aktgjykimit të goditur, ashtu si që pretendohet në ankesë.

Kolegji aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoi sipas detyrës zyrtare dhe në këtë aspekt gjeti se i njëjti nuk përmban shkelje nga neni 139 të LK-së, e të cilat detyrimisht do ta kishim kushtëzuar prishjen e aktgjykimit.

Kolegji, konstatoi se aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë, konkret, përmban arsye për të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje kundërvajtëse dhe në arsyetimin e aktgjykimit të kundërshtuar e ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar si dhe ka dhënë arsyet e qarta për vërtetimin e tillë të fakteve, po ashtu Kolegji i kësaj gjykate i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet të tjera ankimore të cekura në ankesë, mirëpo të njëjtat i vlerësoi se janë të pa bazuara, të pa qëndrueshme si dhe pa ndikim sepse në shkresa të lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të cilave gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të plot dhe të drejtë.

Kolegji i gjykatës së shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj të pandehurit.

Kolegji vlerësoj se gjykata e shkallës së parë, gjatë zbatimit të procedurës, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht aplikim të gabuar të së drejtës materiale, kurse gjoba e shqiptuar ndaj të pandehurit, në shumë prej 4000€, konsiderohet se është caktuar sipas shkallës së përgjegjësisë dhe se është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës kundërvajtëse dhe shkallën e përgjegjësisë dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit.

Konform të nenit 143 par.1 dhe par. 2 të LK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi nuk është e lejuar ankesa.

GYJKATA E APELIT E KOSOVËS

Ka. nr.4/2024, me datë 16.01.2024.



KRYETARJA E KOLEGJIT,
Azra Cakolli